

Data 28.12.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM LAVANDERIE”, NDARË NË 2 LOTE

- ~ **Loti 1 me objekt: “Shërbim i Lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier”, me fond të marrëveshjes kuadër, në vlerën prej: 84,109,000 (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e nëntë mijë) Lekë (pa TVSH) ose 811,471 (tetëqind e njembdhjete mijë e katërqind e shtatedhjetë e nje) Euro (pa TVSH);**
- ~ **Loti 2 me objekt: “Shërbimi i Lavanderisë dhe Hotelerisë për Spitalin Rajonal Fier”, me fond të marrëveshjes kuadër, në vlerën prej: 51 224 000 (pesëdhjetë e një milion e dyqind e njëzet e katër mijë) leke pa TVSH ose 494,201 (katërqind e nëntedhjetë e katër mijë e dyqind e nje) Euro (pa TVSH);**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42716000-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 135,333,000 (njëqind e tridhjetë e pesë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë) Lekë (pa TVSH) Ose 1,305,925 (një milion e treqind e pesë mijë e nënteqind e njezet e pesë) EURO.

Bazuar në kursin zyrtar të këmbimit valutor, sipas Bankës së Shqipërisë datë 28.12.2023 ora 12:29, euro 103.65.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI 1 ME OBJEKT: “SHËRBIM I LAVANDERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E SPITALIT MEMORIAL FIER”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit **SSH EN 14065:2016 / UNI ENI 14065** (e vlefshme) ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e kontrollit të Biokontaminimit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të tillë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit ndaj klientit pra Ak-së . Ky standard evropian përshkruan një qasje të menaxhimit të rrezikut, të quajtur analiza e rrezikut dhe kontrollit të biokontaminimit (RABC), i projektuar për të lejuar pastrimin e produkteve të vazhdueshme për të siguruar cilësinë mikrobiologjike të indeve të trajtuara në lavanderi, pra lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, pasi është pjesa kryesore e objektit të prokurimit është larja e materialeve të kontaminuara të cilat pasi të lahen do të përdoren për shtretërit e pacientëve të sëmurë, apo personelit mjekësor, si dhe për sallat e operacioneve ku çdo gjë duhet të jetë sa më sterile dhe e pastër.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori

ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
 - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kyerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Per sa me sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/përdorim

Vendodhja që do të deklarohej detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

- Krahas deklaratës të paraqesë akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Shënim 2.1:

Në çdo rast, përpara përpara vendimit të perzgjedhjes të kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar për ambjentin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjenti, mjetet dhe pajisjet e posacme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderia, pra operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient për kryerjen e shërbimit të lavanderise. Për këtë është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të provojnë se disponojnë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

3. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Ne zbatim të ligjit Ligj Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, Datë 14.7.2011, “Për Lejet E Mjedisit”, të ndryshuar.

4. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
1	Drejtues Teknik-	1 (një)
2	Punëtore në Lavanderi	5 (pesë)
3	Punonjës Shërbimi në Reparte në AK	7 (shtatë)
	Totali i punonjësve	13 (trembëdhjete)

- Për Drejtuesin Teknik, OE duhet të paraqes:
 - Diplomë
 - Kontrate pune perkatëse.
 - Libreze pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën përkatëse.
 - Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e - albania.
- Per punonjësit, Puntore në Lavanderi te paraqitet vetem kontrate pune perkatëse.
- Per punonjesit punonjës Shërbimi në ambjentet e AK, te paraqitet vetem kontrate pune perkatëse, (per dy punonjes nga punonjesit “Punonjes shërbimi ne Reparte” të paraqitet Leje Drejtimi në përputhje me mjetin e kërkuar, në zbatim të Legjisllacionit në fuqi.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues duhet të paraqesin kontratat individuale të punës, diplomat si dhe cdo dokumantacion plotësues të kërkuar për cdo punonjës pranë AK..

***Shenim 4.1:**

Me qëllim garantimin e gjithë perfshirjes, për ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik për te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Stafi i percaktuar ne numer rendor 3, icili do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor, per zbatimin e kesaj kontrate, nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera, deri ne perfundim te kontrates. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtesi Ligjor i shoqerise.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Autoriteti Kontraktor, referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic është shërbimi i lavanderie ka përcaktuar këtë numër punonjësish në funksion të ofrimit të këtij shërbimi nga operatorët ekonomik- referuar volumit të shërbimit i cili parashikohet të realizohet çdo ditë në këtë spital kërkohet që ofertuesit duhet të vërtetojnë që kanë të punësuar fuqi punëtore minimale në sektorin e shërbimit të objekt prokurimi. Në tabelën e mësipërme janë përcaktuar numri i punonjësve sipas profesioneve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve. Ky numer është kërkuar duke u bazuar ne nevojën per kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes per realizimin e objektit te prokurimit referuar të dhënave elektronike të dërguara nga shërbimi i statistikës, shërbimi në të gjithë AK ofrohet ne numrin e shtretërve. numri i shtreterve mbi të cilën llogaritet aktiviteti spitalor, si dhe pacientet hospitalizohen dhe marrin shërbimin e duhur, kerkesa qe dy punonjes nga punonjesit “Punonjes shërbimi ne Reparte” të paraqitet Leje Drejtimi në përputhje me mjetin e kërkuar, në zbatim të Legjislacionit në fuqi, eshte bere me qellim per te mos kerkuar punonjes vetem ne cilesin Shofer, duke arsyetuar se punonjesit qe do te kryejne shërbimin ne ambjente te AK, mund te bejne edhe transoirtin e materialit te bute.

5. Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Makinë larëse profesionale(me kapacitet mbi 60 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira
2	Barriera larëse profesionale (për larjen e materialeve të kontaminuara) me kapacitet mbi 60 kg secila.	copë	1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira
3	Makinë pastrimi kimik profesionale (për jorgan)	copë	1 (nje) ose me kombinim	Në pronësi ose me qira

	Vatine dhe jastëk, me kapacitet mbi 20 kg)		pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.	
4	Makinë tharëse profesionale (me kapacitet mbi 20 kg secila)	cope	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira
5	Trasportuesa (karrela për transport Rrobash) profesionale (me pompa dezinfektante)	copë	30	Në pronësi ose me qira
6	Kosha metalik (karrela për mbajtje Material i butë) (brenda ambientit të lavanderisë, me kapacitete të ndryshme për të përballuar volumin e punës)	cope	10 (dhjetë)	Në pronësi ose me qira
7	Makineri hekurosëse (rul) profesional (mbi dy metra gjatësi)	cope	1 (një)	Në pronësi ose me qira
8	Kukullat hekurosje uniformash Profesional me avull (për uniformat e personelit ndihmës dhe mjekëve),	Cope	1 (një)	Në pronësi ose me qira
9	Makina paketimi profesionale për paketim Inventari i butë (me kaldaje dhe transportier)	Cope	1 (një)	Në pronësi ose me qira
10	Karroca shërbimi stacionare profesionale Në pavione (me ndarje - me kapak, të pajisur me thasë me ngjyra per vendosjen e materialeve)	Cope	10 (dhjetë)	Në pronësi ose me qira
11	Çanta higjenike për transport materiali butë (për transportin e materialeve)	Cope	50	Në pronësi ose me qira
12	Pompa dizinfektante në karrocet shërbimi në pavione	Cope	5	Në pronësi ose me qira
13	Peshore elektronike mbi 100 kg (për peshimin e materialeve)	Cope	2	Në pronësi ose me qira

Shënim 5.1:

Në çdo rast, përpara përpara vendimit te perzgjedhjes te kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar duhet të paraqesin prane AK dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata

qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Autoriteti Kontraktor, pas dorezimit të dokumentacionit të mesiperm pas publikimit të Njoftimit Fitues, do të verifikoj pranë ambienteve të operatorit ekonomik disponueshmerine e pajisjeve të deklaruar.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Pajisjet e kerkuara qe do të deklarohen detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderi, pra operatori ekonomik do të bëjë larjen sipas specifikimeve, nga Autoriteti Kontraktor. Është e nevojshme disponimi i mjeteve të kerkuara per zbatimin me sukses te kontrates. Kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës dhe konkretisht se disponojnë ambiente për ushtrimin e veprimtarisë së larjes së materialeve të buta, ambient i cilin duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi provuar ky fakt me paraqitjen e dokumenteve të mësipërme; Duhet të disponojnë makineri e përcaktuara në tabelën e mësipërme të cilat i ka kërkuar edhe autoriteti kontraktor si pajisje, për larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, të vërtetuara me dokumentacion. Nisur nga kerkesat e bazes material qe AK ka nevoje si dhe nga sasia e larjes per dite/muaj, operatori ekonomik ne momentin e nenshkrimit te kontrates dhe fillimit te sherbimit ne AK duhet te zoteroje makinerite e sipercituara. per te permbushur objektin e kontates ne menyre qe te sigurohet edhe garancia e cilesise se sherbimit te kerkuar.

6. Operatori ekonomik ne lidhje me materialin e bute te percaktuar ne specifikimet teknike, qe do te paraqese skeden teknike ose katalogun e mallit, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i autorizuar.

Materialët e Buta				SRMF
Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Skede teknike/katalog	Certifikatë konformiteti ose cilësia CE/ekuivalent akredituar
1	Çarçaf shtrati i sipërm			
2	Batanie			
3	Pizhama pacienti			
4	Pandofla pacienti për			
5	Peshqirë personeli/pacienti			
6	Jastëkë /kllëf jastëku			
7	Kllëfë dysheku			
8	Jorgan			
9	Çarçaf			
10	Përparëse mjeku			
11	Përparëse personeli			
12	Përparëse sanitare			
13	Përparëse, uniforma ekipi			

Shënim 6.1:

Në çdo rast, përpara përpara vendimit të perzgjedhjes të kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti.

Te dhenat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për te gene pjesë e planit të zbatimit të kontrates.

Me nënshkrimin e kontrates dhe dorëzimin e materialeve të buta operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi të paraqes prane AK edhe raport testimet perkatese per cdo produkt. Per kete te paraqes detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me raportin perkates i cili duhet te jete sipas kerkesave / specifiimeve teknike te AK.

Argumentimi: Në lidhje me materialet e buta pjesë e kontrates për objektin e prokurimit operatori ekonomik duhet të garantoj se materialet e buta duhet të jete sipas standarteve nderkombetare dhe te akredituara nga organe kompetetnte me qellim permbushjen me sukses te sherbmit te lavanderise sipas nevojave të autoritetit. Si dhe ne perputhje te vendimit te KPP-se 1126/2023.

6. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore” sipas klasifikimit ne Termat e References shtojca 9 e DST:

-Material i kontaminuar”-

-Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.

-Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”

-Material i pisët”

Për detergjentet e pastrimit sipas pikës 8 Seksioni 2.3 i KVK, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë :

- I. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.
- II. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalor”
- III. Tabelen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

Materialet e pastrimit			SRMF	
Nr.	Emërtimi i produktit që do të lahet	Vendi i origjines së produktit të pastrimit	Lloji/Emertimi I detergjentit	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
1	Material i kontaminuar			
2	Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare			

3	Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”			
4	Material i pisët”			

Shënim 7.1:

Në çdo rast, përpara përpara vendimit te perzgjedhjes te kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti.

Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Ne varesi te ndotjes dhe rrezikshmerise qe kane materialet spitalore, operatori ekonomik duhet të garantoj se per sherbimin e lavanderise do te perdor detergjent dhe dizinfektant lares sipas standarteve higjeno -sanitare te certifikuara nga organe te akredituara. Iloje e materialeve të ndotura qe do te lahen, të përcaktuara në Specifikimet teknike, per te cilen operatori ekonomik duhet te specifikoj vendin e origjines se laresve si dhe akreditimin e saj.

8. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjete transporti mallrash me kapacitet sipas specifikimeve teknike, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Targen e mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1			copë		Në pronësi ose me qira

Shënim 8.1: Në çdo rast, përpara përpara vendimit te perzgjedhjes te kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar që të dorëzojë dokumentacion per mjetin e mësipërm, që vërtetojnë pronësinë, qiranë, ose huapërdorjen, (certifikate pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimi të mjetit.

Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderi, pra operatori ekonomik do të bëjë larjen sipas specifikimeve, nga Autoriteti Kontraktor. Kapacitetet teknike të mësipërme janë të domosdoshme për realizimin me sukses te kontratës objekt prokurimi. Operatorët ekonomike duhet të disponojnë të paktën 1(një) mjet transporti mallrash, të cilat duhet ti kenë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin të kërkuar në këtë kriter. Mjeti transportues është 1 nevojshem për transportimin e materialeve të buta nga lavanderia në ambientet e Spitalit dhe anasjelltas. Autoriteti Kontraktor argumenton se është e nevojshme disponimi i mjeteve te kerkuara per zbatimin me sukses te kontrates. Operatorët ekonomike duhet të disponojnë të paktën 1(nje) mjettransporti mallrash, nisur nga volumi i materialeve të buta të cilat do të trajtohen, mjetet të cilat duhet të kenë kapacitete transportuese mbi 1 Ton, me qëllim transportin e mallit, të cilat duhet ti kenë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin të kërkuar në këtë kriter. Mjetet e transportit janë të nevojshme për transportimin e materialeve të buta nga lavanderia në ambientet e ak së dhe anasjelltas.

9. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentimi: *Me anë të kësaj deklaratë operatori ekonomik duhet të garantoj së shërbimi I lavanderisë do të kryhet sipas standarteve në fuqi me qëllim garantimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të praqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

LOTI 2 ME OBJEKT: “SHERBIMI I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR SPITALIN RAJONAL FIER”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 11*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit **SSH EN 14065:2016 / UNI ENI 14065** (e vlefshme) ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e kontrollit të Biokontaminimit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të tillë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit ndaj klientit pra Ak-së. Ky standard evropian përshkruan një qasje të menaxhimit të rrezikut, të quajtur analiza e rrezikut dhe kontrollit të biokontaminimit (RABC), i projektuar për të lejuar pastrimin e produkteve të vazhdueshme për të siguruar cilësinë mikrobiologjike të indeve të trajtuara në lavanderi, pra lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, pasi është pjesa kryesore e objektit të prokurimit është larja e materialeve të kontaminuara të cilat pasi të lahen do të përdoren për shtretërit e pacientëve të sëmurë, apo personelit mjekësor, si dhe për sallat e operacioneve ku çdo gjë duhet të jetë sa më sterile dhe e pastër.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

2.3 Kapaciteti teknik:

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - c) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - d) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim **të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kyerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit.**

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

Vendodhja qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

- Krahas deklarates te paraqes akt miratimi higjeno – sanitar per kete ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Shënim 2.1:

Në çdo rast, përpara përpara vendimit te perzgjedhjes te kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar për ambientin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjenti, mjetet dhe pajisjet e posacme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderia, pra operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient per kryerjen e shërbimit te lavanderise. Për ketë është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të provojnë se disponojnë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

7. Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Ne zbatim te ligjit Ligj Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, Datë 14.7.2011, “Për Lejet E Mjedisit”, të ndryshuar.

8. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
1	Drejtues Teknik-	1 (një)
2	Punëtore në Lavanderi	5 (pesë)
3	Punonjës Shërbimi në Reparte në AK	7 (shtatë)
	Totali i punonjësve	14 (trembëdhjete)

- Për Drejtuesin Teknik, OE duhet te paraqes:
 - Diplomë
 - Kontrate pune perkatese.
 - Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën përkatëse.
 - Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e lëshuar nga e - albania.

- Per punonjësit, Puntore në Lavanderi te paraqitet vetem kontrate pune perkatese.
- Per punonjesit punonjës Shërbimi në ambientet e AK, te paraqitet vetem kontrate pune perkatese, (per dy punonjes nga punonjesit “Punonjes sherbimi ne Reparte” të paraqitet Leje Drejtimi në përputhje me mjetin e kërkuar, në zbatim të Legjislacionit në fuqi.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes
----	--------------	------------	---

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues duhet të paraqesin kontratat individuale te punës, diplomat si dhe cdo dokumantacion plotësues të kërkuar për cdo punonjës prane AK..

***Shenim 4.1:**

Me qellim garantimin e gjithë perfshirjes, per ti dhene mundesi cdo operatori ekonomik per te marre pjese ne proceduren perkatese te prokurimit, punonjesit e mesiperm jo domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Punonjesit mund te kontraktohen nga operatori ekonomik enkas per kete procedure prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Stafi i percaktuar ne numer rendor 3, icili do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor, per zbatimin e kesaj kontrate, nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera, deri ne perfundim te kontrates. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtesi Ligjor i shoqerise.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Autoriteti Kontraktor, referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic është shërbimi i lavanderie ka përcaktuar këtë numër punonjësish në funksion të ofrimit të këtij shërbimi nga operatorët ekonomik- referuar volumit të shërbimit i cili parashikohet të realizohet çdo ditë në këtë spital kërkohet që ofertuesit duhet të vërtetojnë që kanë të punësuar fuqi punëtore minimale në sektorin e shërbimit të objekt prokurimi. Në tabelën e mësipërme janë përcaktuar numri i punonjësve sipas profesioneve të nevojshme për kryerjen e shërbimeve. Ky numer është kërkuar duke u bazuar ne nevojën per kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes per realizimin e objektit te prokurimit referuar të dhënave elektronike të dërguara nga shërbimi i statistikës, shërbimi në të gjithë AK ofrohet ne numrin e shtretërve. numri i shtreterve mbi të cilën llogaritet aktiviteti spitalor, si dhe pacientet hospitalizohen dhe marrin shërbimin e duhur, kerkesa qe dy punonjes nga punonjesit “Punonjes sherbimi ne Reparte” të paraqitet Leje Drejtimi në përputhje me mjetin e kërkuar, në zbatim të Legjislacionit në fuqi, eshte bere me qellim per te mos kerkuar punonjes vetem ne cilesin Shofer, duke arsyetuar se punonjesit qe do te kryejne shërbimin ne ambiente te AK, mund te bejne edhe transoirtin e materialit te bute.

9. Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
----	---------------	--------	-----------------	---------

1	Makinë larëse profesionale(me kapacitet mbi 50 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira
2	Makinë tharëse profesionale (me kapacitet mbi 50 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira
3	Makineri hekurosëse (rul) professional	copë	2 (dy)	Në pronësi ose me qira
4	Makineri Paketimi Profesionale per paketim rrobash	cope	1 (nje)	Në pronësi ose me qira
5	Makineri barriera larese profesionale(minimalisht 50 kg)	copë	1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.	Në pronësi ose me qira
6	Kosha metalik (karrela për mbajtje Material i butë) (brenda ambientit të lavanderisë, me kapacitete të ndryshme për të përballuar volumin e punës)	cope	10 (dhjetë)	Në pronësi ose me qira
7	Karrela karroca (karrela sherbimi ne pavion per rrobat)	cope	10 (dhjetë)	Në pronësi ose me qira
8	Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet te jete kalibruar dhe te shoqerohet me akt kolaudimi te leshuar nga autoritetet perkatese(Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise)	Cope	1 (nje)	Në pronësi ose me qira

Shënim 5.1:

Në çdo rast, përpara përpara vendimit te perzgjedhjes te kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar duhet të paraqesin prane AK dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Autoriteti Kontraktor, pas dorezimit të dokumentacionit të mesiperm pas publikimit të Njoftimit Fitues, do të verifikoj prane ambienteve të operatorit ekonomik disponueshmerine e pajisjeve të deklaruar.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet rocedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Pajisjet e kerkuara qe do te deklarohen detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderi, pra operatori ekonomik do të bëjë larjen sipas specifikimeve, nga Autoriteti Kontraktor. Është e nevojshme disponimi i mjeteve të kerkuara per zbatimin me sukses te kontrates. Kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës dhe konkretisht se disponojnë ambiente për ushtrimin e veprimtarisë së larjes së materialeve të buta, ambient i cilin duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi provuar ky fakt me paraqitjen e dokumenteve të mësipërme; Duhet të disponojnë makineri e përcaktuara në tabelën e mësipërme të cilat i ka kërkuar edhe autoriteti kontraktor si pajisje, për larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karrela shërbimi deri tek shtrati i pacientit, të vërtetuara me dokumentacion. Nisur nga kerkesat e bazes material qe AK ka nevojë si dhe nga sasia e larjes per dite/muaj, operatori ekonomik ne momentin e nenshkrimit te kontrates dhe fillimit te sherbimit ne AK duhet te zoteroje makinerite e sipercituara. per te permbushur objektin e kontates ne menyre qe te sigurohet edhe garancia e cilesise se sherbimit te kerkuar.

- 10.** Operatori ekonomik ne lidhje me materialin e bute te percaktuar ne specifikimet teknike, qe do te paraqese skeden teknike ose katalogun e mallit, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i autorizuar.

Materialet e Buta				SRF
Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Skede teknike/katalog	Certifikatë konformiteti ose cilësia CE/ ekuivalent akredituar
1	Kellefe jasteku			
2	Çarçaf shtrati i siperm			
3	Çarçaf shtrati i poshtem			
4	Çarçaf per femije			
5	Mbulese e gomuar			
6	Mbulese e gomuar per krevate			
7	Çarçaf zarf			
8	Çarçaf zarf per femije			
9	Peshqire (personeli,patient)			
10	Pizhama pacienti			
11	Perparese			
12	Kostume			
13	Kostume sanitare/kuzhiniere			
14	Pandofla personeli/pacienti			
15	Batanije per te rritur			
16	Batanije per te vegjel			

17	Jorgane me vatine			
18	Jorgane me vatine te vegjel			

Shënim 6.1:

Në çdo rast, përpara përpara vendimit te perzgjedhjes te kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti.

Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e materialeve te buta operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi te paraqes prane AK edhe raport testimet perkatese per cdo produkt. Per kete te paraqes detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me raportin perkates i cili duhet te jete sipas kerkesave / specifiimeve teknike te AK.

Argumentimi: Në lidhje me materialet e buta pjesë e kontrates për objektin e prokurimit operatori ekonomik duhet të garantoj se materialet e buta duhet të te jene sipas standarteve nderkombetare dhe te akredituara nga organe kompetetnte me qellim permbushjen me sukses te sherbmit te lavanderise sipas nevojave të autoritetit. Si dhe ne perputhje te vendimit te KPP-se 1126/2023.

11. Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore” sipas klasifikimit ne Termat e References shtojca 9 e DST:

-Material i kontaminuar”-

-Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.

-Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”

-Material i pisët”

Për detergjentet e pastrimit sipas pikës 8 Seksioni 2.3 i KVK, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë :

- IV. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.
- V. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalor”
- VI. Tabelen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

Shënim 7.1:

Në çdo rast, përpara përpara vendimit te perzgjedhjes te kandidateve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti.

Te dhenat qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Ne varesi te ndotjes dhe rrezikshmerise qe kane materialet spitalore, operatori ekonomik duhet të garantoj se per sherbimin e lavanderise do te perdor detergjent dhe dizinfektant lares sipas standarteve higjeno -sanitare te certifikuara nga organe te akredituara. lloje e materialeve të

ndotura qe do te lahen, të përcaktuara në Specifikimet teknike, per te cilen operatori ekonomik duhet te specifikoj vendin e origjines se laresve si dhe akreditimin e saj.

12. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjete transporti mallrash me kapacitet sipas specifikimeve teknike, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Targen e mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1			copë		Në pronësi ose me qira

Shënim 8.1: Në çdo rast, përpara përpara vendimit të perzgjedhjes të kandidatëve/publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ofertuesi i kualifikuar që të dorëzojë dokumentacion për mjetin e mësipërm, që vërtetojnë pronësinë, qiranë, ose huapërdorjen, (certifikate pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimit të mjetit.

Mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është lavanderi, pra operatori ekonomik do të bëjë larjen sipas specifikimeve, nga Autoriteti Kontraktor. Kapacitetet teknike të mësipërme janë të domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Operatorët ekonomike duhet të disponojnë të paktën 1(një) mjet transporti mallrash, të cilat duhet ti kenë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin të kërkuar në këtë kriter. Mjeti transportues është I nevojshem për transportimin e materialeve të buta nga lavanderia në ambientet e Spitalit dhe anasjelltas. Autoriteti Kontraktor argumenton se është e nevojshme disponimi i mjeteve të kerkuara për zbatimin me sukses të kontrates. Operatorët ekonomike duhet të disponojnë të paktën 1(nje) mjettransporti mallrash, nisur nga volumi i materialeve të buta të cilat do të trajtohen, mjetet të cilat duhet të kenë kapacitete transportuese mbi 1 Ton, me qëllim transportin e mallit, të cilat duhet ti kenë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin të kërkuar në këtë kriter. Mjetet e transportit janë të nevojshme për transportimin e materialeve të buta nga lavanderia në ambientet e ak së dhe anasjelltas.

13. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate operatori ekonomik duhet të garantoj së shërbimi I lavanderisë do të kryhet sipas standarteve në fuqi me qëllim garantimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklarata të rreme, të praqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **30/01/2024**; Ora: **11:00**; Vendi: www.app.gov.al, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, Tiranë.